



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË VEÇANTË TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 21 MAJ 2019**

**SA POSEBNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 21. MAJA 2019. GODINE**

**MAJ - MAJ
2019**

Rendi i ditës

1. Përkujtimi i 20-vjetorit të Masakrës në Burgun e Dubravës

Dnevni red

2. Sećanje na 20. godišnjicu masakra u Zatvoru u Dubravi

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Shumë të nderuar të mbijetuar të masakrës së Dubravës,
I hap punimet e seancës së veçantë dhe do të procedojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Përkujtimi i 20-vjetorit të masakrës në Burgun e Dubravës

Ftoj deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës në nderim të të rënëve në masakrën e Dubravës të ngrihem në këmbë për një minutë heshtje.

(Një minutë heshtje)

Lavdi e përjetshme!

Të nderuar deputetë,
Unë do të ftoj menjëherë njërin nga njerëzit që i ka mbijetuar këtij krimi të gjenocidit të Serbisë, deputetin e Partisë Demokratike të Kosovës, Nait Hasani, që ta marrë fjalën të flasë në hapje të kësaj seance. Nait, fjala për ju.

NAIT HASANI: Të nderuar bashkëvuajtës,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryetar,

I nderuar Kabinet,

Në debatin e sotëm për masakrën në burgun e Dubravës, të thirrur këtë seancë të veçantë, kërkojmë të trajtohet një nga masakrat më të tmerrshme të ndodhura më 19-24 maj 1999 në Burgun e Dubravës, në Istog, nga gardianët, policët, ushtarët dhe të burgosurit serbë mbi të burgosurit shqiptarë.

Të nderuar deputetë,

Ne mendojmë se qëllimi i masakrës ka qenë i planifikuar dhe i përgatitur mirë që nga udhëheqja qendrore e Serbisë e deri te gardianët e Burgut të Dubravës.

Këtë e dëshmon mbledhja e të burgosurve në Burgun e Dubravës që na sollën aty mua edhe 63 të tjerë nga Burgu i Mitrovicës së Sremit, nga Burgu i Nishit, nga Burgu i Prizrenit, nga Burgu i Gjilanit, nga Burgu i Pejës dhe ta zënë robër lufte nga Suhareka, Gjilani, Gjakova e tërë Kosova, na mblodhën nga 29 prill 1999 deri nga mesi i majit 1999 në Burgun e Dubravës.

Kjo mbledhje e të burgosurve shqiptarë në Dubravë ishte mish për top, sepse në këtë kohë Serbia kishte vendosur sistemin e komunikimit të radarëve ushtarakë dhe pistën e avionëve në Burgun e Dubravës pas tërheqjes së të burgosurve shqiptarë nga ky burg në burgjet e tjera në Serbi dhe sa kishte qenë i zbrazët, aty ishin vendosur policia dhe ushtria serbe.

Me këtë qëllim për t'i mbrojtur këtë strukturë raketore e të radarëve të ushtrisë serbe dhe kur NATO të sulmojë këtë burg që ishte lajmëruar se aty ka policë e ushtarë serbë, që ndërkohë ushtria e policia serbe kishin dalë jashtë oborrit të burgut dhe brenda na kishin vendosur neve të burgosurit shqiptarë, mbi 960 të burgosur.

Të nderuar deputetë,

Në datën e sotme kur ne debatojmë për masakrën e Burgut të Dubravës, pikërisht në këtë datë para 20 vjetëve filloi bombardimi i burgut nga avionët e NATO-s të pikave raketore, radarëve të ushtrisë serbe në Burgun e Dubravës, ku u vranë nga bombardimet e NATO-s mbi 20 të burgosur.

Dhe fillimi i bombardimeve ka qenë i ditur nga drejtuesit e shtetit serb që do të ndodhin në këtë burg dhe ne duhet të jemi ata që do të jem vrasje me paramendim në këtë burg për mbrojtjen e sistemit të tyre kundërzbulues që ishte instaluar në burg, do të ishim viktimat e kësaj loje kriminale.

Ajo që ka ndodhur ato ditë në Burgun e Dubravës nuk ka mundësi as ta imagjinojë as skenarë të filmave, por kjo masakër u realizua ashtu siç ishte edhe planifikuar, sepse duhet të vriteshin shqiptarë dhe të burgosurit sa më shumë që ishte e mundur dhe fajtor të ishte NATO-ja për këtë masakër.

Për atë që s'mund ta realizuar me djallëzinë që krimet t'ia linin NATO-s, e realizuan vetë shteti serb më 22 deri më 24 maj 1999.

Të nderuar deputetë,

Këtë po e them e po e trajtoj këtu, e që dëshmoj me kallëzimin penal që është bërë në Prokurorinë e Pejës më 19 janar 2007.

Ka për qëllim që të nxjerrë në shesh një masakër të tmerrshme që ka ndodhur në kohën e luftës në Kosovë në fund të shekullit XX, e cila nuk mund të ketë krahasim as me krimet e Bosnjës në Srebrenicë që Serbia na terrorizoi neve shqiptarëve në burgje të saj mbi ndërgjegjen evropiane. Kjo ndërgjegje u vra nga ushtria e policia serbe, së bashku me gardianët e burgut dhe të burgosurit serbë që na vranë mbi 130 të burgosur dhe plagosën mbi 300 të tjerë.

Këtu kemi edhe kallëzimin penal, është i datës 19 janar 2007, i bërë nga Shoqata e të Burgosurve, që sot janë këtu edhe i falënderojmë dhe asnjë veprim nuk është marrë prej asaj kohe, për 12 vjet. Prandaj, unë them që nuk është trajtuar nga drejtësia prej asaj kohe deri më sot.

Vrasjet u bënë nga ata që kishin marrë përgjegjësi t'i mbrojnë në bazat e konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve dhe pengjet të luftës, këta kriminelë na sulmuan dhe na vranë pa pyetur për konventa e ligje lufte, gjë që kjo është një masakër e gjenocid i shtetit serb kundër të burgosurve shqiptarë.

Të nderuar deputetë,

Jo vetëm kaq, nuk mund të tejkalohej masakra në Burgun e Dubravës pa e ditur se ku është profesori Ukshin Hoti.

Të gjithë të mbijetuarit e masakrës së Burgut të Dubravës e dinë që në këtë burg ka qenë Ukshin Hoti dhe të gjithë e dinë se Ukshin Hotin e ka marrë nga dhoma e Burgut gardiani Branko Komadina.

Të gjithë e dimë se në këtë burg ka qenë përgjegjës drejtori Aleksandër Rakoçeviq Aca, pas luftës ka qenë drejtor edhe në CZ, apo në Burgun Qendror të Beogradit, ku na ka trajtuar neve atje.

Të gjithë e dimë se komandant burgu ka qenë Miodrag Vidiq Miki, që këta të dy, Aca dhe Miki, së bashku me mbikëqyrësin e burgut Branko Komadina e dinë se ku është dhe cili është apo ku ka qenë fati i Ukshin Hotit pas daljes nga burgu më 16 maj 1999.

Këta janë përgjegjës të drejtpërdrejtë për jetën e Ukshin Hotit, këta kriminelë sot shëtiten të lirë nëpër Serbi, këta edhe sot janë të lirë, kanë marrë pozitat në burgje të Serbisë, dikush është bërë drejtor, dikush gardian, komandant të burgut, këta janë shpërblyer me pozita për krimet që kanë bërë në Burgun e Dubravës.

Pra, nxjerrjen e Ukshin Hotit nga burgu nga gardianët e burgut të zhduket dhe të mos përgjigjet askush nga ta, ky është krim që ndëshkohet me të gjitha ligjet ndërkombëtare dhe konventat mbi të drejtat e të burgosurve dhe pengjet e luftës.

Prandaj, këta kriminelë duhet të arrestohen, të gjykohen e të marrin dënimin e merituar.

Të nderuar deputetë,

Me këtë dua të them se deri më sot askush nuk ka çarë kokën për këtë masakër në Burgun e Dubravës, asnjë qeveri jona nuk ka bërë asgjë, kanë heshtur të gjithë, me qëllim apo pa qëllim.

Askush nuk di kush ka kërkuar nga ndërkombëtarët që të heshtin këtë masakër, këtë s'e dimë ne, por e dimë që se të gjithë nuk kanë bërë asgjë që të zbardhet kjo masakër në burg.

Po për këtë masakër në Burgun e Dubravës nuk ka çarë kokën as Prokuroria e Pejës që 12 vjet, që kur e kemi bërë publike kallëzimin penal në emër të Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës më 19 janar 2007, për 12 vjet është heshtur kjo masakër dhe ky kallëzim penal në këtë prokurori dhe kërkoj nga ministri i Drejtësisë të japë shpjegim: pse është heshtur ky kallëzim penal i bërë nga Shoqatat e të Burgosurve Politikë në Prokurorinë e Pejës dhe nga kush është heshtur, kush ka ndikuar që të heshtet ky krim, kjo heshtje do të thotë të bësh për së dyti krim.

Prandaj, mua dhe të tjerëve të mbijetuarve na intereson cili ka qenë qëllimi që për këtë kallëzim penal nuk është ngritur aktakuzë kundër kriminelëve për krime lufte në Burgun e Dubravës, të paditur nga shoqata.

Pse kryeprokurori i Pejës nuk ka parë të udhës që as të ngre aktakuzë kundër të pandehurës nga ky kallëzim penal, kjo dëshmon me fakte e fotografi në vendin e krimit dhe kriminelëve dhe me dëshmi mbi të 40 të burgosurve.

Këtu e kemi edhe librin, një libër që është botuar në vitin 2011, ky është komandanti i burgut, Miki. Këtu janë vrasësit, këtu janë të vrarët, këtu është spitali, të vrarët dhe duke gjuajtur drejtpërdrejt mbi të burgosurit.

Ka edhe shumë, sepse deri më tash 12 vjet është bërë kjo heshtje dhe kujt i ka interesuar kjo heshte, Prokurorisë së Pejës, UNMIKU-të të atëhershëm, EULEX-it apo Serbisë që kjo masakër në Burgun e Dubravës të heshtet.

Të nderuar deputetë,

Unë mendoj se edhe ish-prokurorëve e kryeprokurorëve në Kosovë, edhe UNMIK-ut, edhe EULEX-it u është dashur të heshtet ky krim e kjo masakër e tmerrshme, sepse së bashku këto tri institucione janë të lidhura direkt apo indirekt me pushtetin kriminal serb.

Kjo tregon se kryeprokurori i Pejës nuk e ka parë të arsyeshme që masakrën në Burgun e Dubravës, ku janë vrarë mbi 130 burgosur dhe janë plagosur mbi 300 të tjerë, në forma të ndryshme të ngre aktakuzë dhe të kërkojë drejtësi që të vihen para drejtësisë këta kriminelë. Të tregon përgjegjësinë morale e politike të prokurorisë, të tregon papërgjegjshmërinë e tyre prokuroriale dhe njerëzore.

Të nderuar deputetë,

Këtë debat e kam kërkuar që është një mundësi që opinioni, qytetarët tanë dhe ndërkombëtarët të njihen përsëri për të satën herë në 20-vjetorin e kësaj masakre me të ngjarje të dhimbshme në luftën tonë për liri që ka ndodhur në Burgun e Dubravës.

Ky debat për të kërkuar përgjegjësi nga institucionet tona dhe për të dëshmuar edhe një herë me faktografi para Ministrisë së Drejtësisë sonë dhe të bashkësisë ndërkombëtare, te ambasadorët, te shtetet e BE-së në Kosovë dhe ambasadori amerikan në Kosovë, zotit Kosnet, se çdo masakër në Kosovë i ka kriminelët e vet që kanë vrarë e prerë shqiptarë.

Unë kam nënshkruar edhe dy dëshmi që i kam, më 22. 2. 2017 i jam drejtuar ambasadorit amerikan Dellavi, pikërisht edhe për EULEX-in për asnjë veprim që nuk ka marrë deri më tash.

Po ashtu iu kemi drejtuar të njëjtën kohë, në të njëjtën ditë edhe Parlamentit Evropian, zonjës Lunaçek, po ashtu nuk kanë marrë asnjë veprim, askush nuk e ka trajtuar këtë çështje.

Ne kemi po ashtu edhe një vendim të datës 19 maj 2011 nga Kuvendi i Kosovës pikërisht për t'i përshpejtuar procedurat e drejtësisë ndaj kriminelëve që kanë bërë në Burgun e Dubravës.

Masakrat nuk janë vetëm e Dubravës, po janë e Reçakut, masakra e Likoshanit, masakra e Qirezit, masakra e Mehës, masakra e Celinës, masakra e Bellacërkvës, masakra e Krushës, e Krushës së Vogël, Krushës së Madhe, masakra e Rugovës, masakra e Lubeniqit, masakra e Qyshkut të Pejës, masakra e Obrisë dhe familjes Deliu dhe vrasja e fëmijëve dyvjeçarë, masakra e Korishës, masakra e Suharkeës, familjes Berisha, ku janë vra gra e fëmijë dhe gra shtatzënë.

Kjo tregon se secila masakër ka kriminelët e vet, të cilët dihen emrat kush janë dhe kjo kërkon dënimin e kriminelëve në çdo vend, e jo të heshtet para krimit.

Kriminelët serbë sot janë të lirë dhe në pozita të ndryshme dhe të kamufluar edhe në institucionet e policisë e të drejtësisë në Kosovë.

Prokuroria jonë ka heshtur deri më tash, ashtu mendoj unë, me sugjerimet e miqve ndërkombëtarë, duke besuar të krijojnë pajtim mes shqiptarëve dhe serbëve, duke harruar atë çka ka ndodhur në Kosovë.

Po pajtimi nuk mund të krijohet nëse nuk dënohet ai që ka bërë krim dhe kriminelët që kanë bërë krimin.

Dhe në këtë drejtim mund t'i bëj pyetje ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Punëve të Brendshme: sa kriminelë janë dënuar për krimet e masakrat që janë bërë në Kosovë?

Sa kriminelë janë dënuar për masakrën në Burgun e Dubravës, asnjë. Pra mund të them asnjë.

Në këtë masakër në Burgun e Dubravës ka marrë pjesë drejtpërdrejt shteti serb, me ushtrinë dhe policinë, kanë marrë pjesë gardianët e burgut me komandantët e tyre, sepse shteti serb na kishte marrë në mbrojtje në burgje që duhet të garantonte jetën tonë në bazë të konventave ndërkombëtare për robërit e luftës, por shteti serb na vrau, na masakroi, i shkeli këto konventa ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,

Ne kemi bërë kallëzim penal, kemi bërë publik emrat e kriminelëve, kemi prezantuar me fakte, fotografi, kriminelët me armë, me pushkë dhe marrje në shënjestër duke vrarë shqiptarë në Burgun e Dubravës. Kemi për aq që mund të bëhet në një shtet ligjor, kem prezantuar dëshmitë, sepse besojmë në drejtësi.

Dhe tash, sot u bë 20 vjet pas dhe s'ka drejtësi. Pse drejtësia po hesht?

Sot duke fol në këtë debat, në kokën time me dalje në skemë një ngjarje e tmerrshme, pamje të frikshme të të burgosurve duke bërtitur, duke kërkuar ndihmë, ku ka qenë qëndrim në ndërgjegjen time dhe të shokëve se nuk bënë të ligështohemi. Pra, para krimeve vrastare, sepse 'mjerë ai që nuk qëndron'.

Në fund kërkoj që në bazë të debatit të miratohet një rekomandim që Kuvendi i Kosovës të kërkojë nga organet e drejtësisë që të ndërmarrë veprime ligjore ndaj kryesve të krimeve edhe të ngritë aktakuzë me qëllim të gjyqimit të krimeve të luftës me rastin e masakrës së Burgut të Dubravës.

E falënderoj ministrin e asaj kohe të Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi, që e ka mundësuar botimin e këtij libri për masakrën e Dubravës. Ky libër do t'i shërbejë gjeneratës sonë, brezave të ardhshëm, studiuesve, artistëve, skenaristëve për të krijuar filma, do t'i shërbejë kujtesës së popullit tonë që ka kaluar nëpër burgje të Serbisë më 1998-1999.

Ky libër besoj prek ndërgjegjen e institucioneve tona ndërkombëtare për luftimin e krimit dhe vënien para drejtësisë të kriminelëve që bënë këtë lojë mbi të burgosurit shqiptarë në masakrën në Dubravë. Të gjitha familjet që u janë vrarë prindërit, fëmijët e tyre në masakrën e Burgut të Dubravës kur e dëgjojnë këtë debat sot kërkojnë në ndërgjegje drejtësi dhe të dënohen kriminelët serbë që na kanë vrarë në burg.

Lavdi të rënëve në Burgun e Dubravës! Faleminderit!

KRYETARI: E falënderojmë Nait Hasanin. Tani ftoj një të mbijetuar tjetër, po ashtu të masakrës së Dubravës, deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Liburn Aliun.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm, familjarë të të rënëve në masakrën e Dubravës dhe shokë të mbijetuar të kësaj masakre,

Këtyre muajve jemi duke shënuar 20-vjetorë të shumë ngjarjeve dhe masakrave, të cilat i paraprijnë çlirimit të Kosovës. Është e rëndë të flasësh për masakrat dhe vuajtjet e popullit tonë në rrugën e tij për çlirim, e rëndë të përshkruash vuajtjen dhe humbjen e atyre jetëve, të atyre të rinjve të shumtë nëpër këto beteja e masakra.

Por, rrëfimin tonë e bën më të lehtë krenaria që ndjejmë për guximin, vullnetin dhe vendosmërinë e atyre djemve që ranë. Masakra në Burgun e Dubravës për nga tmerret dhe mizoritë nuk dallon nga masakrat e tjera dhe vuajtjet e popullit tonë jo vetëm në luftën e fundit, por edhe në luftërat e mëhershme që populli ynë përjetoj dhe bëri gjatë viteve të shekullit që shkoi. Të veçantë këtë masakër e bën vendi dhe mënyra se si ndodhi ajo. Masakra në burg, ndaj të burgosurve të paarmatosur dhe të mbyllur. Të mbyllur në një hapësirë katrore prej diku deri 12 deri 13 hektarë, në cepat e të cilit janë ato kullat e vrojtimit dhe kjo hapësirë rrethohet me mur që është diku 4 deri 5 metra i lartë.

Brenda kësaj hapësire gjendeshin rreth 1 mijë të burgosur, të cilët në këto ditë, që sot i kemi ditë të majit të vitit '99 para 20 vjetësh u goditën dhe u gjuajtën nga të katër anët dhe të cilët nuk kishin mundësi lëvizjeje, pra në cilëndo lëvizje që mund ta bënë në përpjekje për t'u shpëtuar gjuajtjeve të vazhdueshme nga serbët, kudo që përpiqeshin të fshiheshin, prapë gjendeshin para njerëzve nga këto kulla të vrojtimit, të cilët gjuanin pandërprerë. Të gjithë këta të burgosur kanë qenë të regjistruar nëpër dokumente zyrtare, të gjithë ata kanë pasur ose fletarrestime, ose aktakuza, ose kanë qenë të dënuar. Shumica e tyre janë vizituar dhe regjistruar nga Organizata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq, gjatë tërë kohës dhe deri në ditën e masakrës, duke u bërë numërimi, rinumërimi dhe vëzhgimi i vazhdueshëm nga organet zyrtare, çdo gjë sipas procedurave të parapara e të rregullta nga organet shtetërore.

Datat 19 deri 23-24 maj shënojnë momentet se si ky mekanizëm shtetëror, mbajtës dhe torturues dhe i maltretimit ndaj të burgosurve, sistem ky pjesë i një zinxhiri të mirorganizuar shtetëror deri në nivele të larta ministrore, qeveritare, shndërrohet përnjëherë në një mekanizëm i cili vret në masë. Këtyre datave i paraprin data 16 maj, ku nga burgu u mor profesor Ukshin Hoti dhe për nga natyra e krimit kidnapimi i tij nuk mund të trajtohet si ngjarje në vete, por është pjesë e të njëjtit zinxhirë të ngjarjeve në Dubravë. Pra, realisht krimi në Dubravë do të duhej të konsiderohej nga data 16, pra momenti i kidnapimit të profesor Ukshin Hotit, për të cilin askush në Serbi ende nuk ka treguar se ku gjendet. Pra, nëse Serbia për masakrat e shumta në Kosovë përpiqet të hedhë përgjegjësi te njësitet e caktuara, te të cilat gjoja nuk paska pasur mundësi të

ketë kontrollin mbi ta, te ngjarjet e Dubravës dhe kjo e bën të veçantë këtë ngjarje, ka qenë e përfshirë drejtpërdrejt struktura shtetërore, qeveritare dhe jo vetëm militare, e që në hierarki përfshin nga roja e thjeshtë, tek drejtorët, ministrat, kreu i Qeverisë dhe i shtetit serb. Masakrës së Dubravës nuk i mungojnë dëshmitë e rrëfimet, as faktet dhe dokumentet. Madje, konsideroj se është një ndër krimet më të dokumentuara të Serbisë. Të gjallë janë dëshmitarët e kësaj masakre, e që një pjesë të tyre sot i kemi prezentë këtu në sallë. Të freskëta janë kujtimet, edhe pse kanë kaluar 20 vjet. Edhe përkundër kësaj, ende nuk ka drejtësi për këtë krim, si dhe për të gjitha krimet nga Serbia.

As ndërkombëtarët dhe as ne nuk e bëmë punën që duhej bërë, edhe përkundër ekzistencës së dëshmimeve dhe fakteve. Faktet janë grumbulluar, dëshmitë janë dhënë, janë botuar edhe libra, madje janë bërë edhe dokumentarë. Ata që përjetuan dhe mbijetuan e bënë punën e tyre, pjesën e tyre të punës e kryen ashtu si duhet. Të gjitha këto dëshmi u grumbulluan, u botuan dhe përfunduan deri edhe në kallëzim penal nga Shoqata e të Burgosurve Politikë. Por, më tej këtu ngeci drejtësia, nuk u bë aktakuza dhe kjo bie në përgjegjësi të shtetit edhe të autoritetit ndërkombëtar. Që të dyja mund të fajësojnë sot njëra-tjetrën, te ne thuhet e mund të thuhet se nuk vepruam, sepse pritëm që ta bëjnë këtë punë ndërkombëtarët, ndërsa te të njëjtit ndërkombëtarë dëgjon shpeshherë përgjigjen e dështimit të autoriteteve vendore. Përgjatë këtyre viteve Kosova negocioi me Serbinë dhe gjatë kësaj periudhe sikur u ngri puna për vënien e drejtësisë, madje edhe Instituti për Hulumtim të Krimeve të Luftës që u hap, u mbyll, duke u hedh përgjegjësia tek punëtorët që punonin aty dhe jo tek autoritetet shtetërore. Kësisoj, duke u hedh faji gjetkë, ne fatkeqësisht dështuam të bëjmë hapa konkretë në vënie të drejtësisë, në ndërkohë e njëjta Serbi me të cilin po negocionim nuk pushonte së ngrituri padi të pabazuara dhe trillime, e që për pasojë shumë nga luftëtarët tanë çlirimtarë përfunduan në burgje.

Serbia nuk priti që përndjekjen ndaj shqiptarëve të vazhdojë përmes gjykatave të tyre dhe nuk priti që këtë t'ia bëjnë ndërkombëtarët, e bëri vetë, trilloi dhe s'u ndal së trilluari dhe hartuari padi ndaj nesh. Neve nuk na shfaqëson në asnjë moment arsyetimi se pritëm që gjatë këtyre viteve ta bëjnë punën e tyre ndërkombëtarët. Edhe sot, pra, para se të presim ta bëjnë punën e tyre ndërkombëtarët, duhet të bëjmë ne punën tonë, të marrim masa konkrete si në ligje, si në riaktivizimin e Institutit, si me ndërtimin e ekipeve në të gjitha nivelet e drejtësisë që do të bëjnë punën e tyre, e në këtë aspekt nuk duhet të dështojmë më. Ndërsa, në mungesë të drejtësisë ajo që mbetet për të mbijetuarit dhe familjet e të rënëve nga këto ngjarje janë kujtimet dhe rrëfimet, të cilat nuk mund t'ua marrë askush. Ata që përjetuan masakrën e Dubravës kujtojmë dhe nuk ua merr dot askush kujtimin për ata shokë që ranë, për dashurinë për njëri-tjetrin, kujtime, guxim dhe solidaritetin e treguar në ato ditë të rënda. Lavdi të rënëve të kësaj masakre dhe masakrave të tjera e luftëtarëve në luftën tonë çlirimtare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Rasim Selmanaj, po ashtu i mbijetuar i masakrës së Dubravës.

RASIM SELMANAJ: Të nderuara familje të të rënëve në masakrën e Burgut të Dubravës,
Të nderuar të mbijetuar të kësaj masakre,
Të nderuar kolegë deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Duke qenë njëri nga të mbijetuarit e kësaj masakre, fjala ime do të jetë një rrëfim autentik që do të mundohem, për aq sa më lejon koha, të sjell fakte dhe dëshmi se si ndodhi masakra në Burgun e Dubravës, gjithnjë sipas përjetimit tim.

Sepse, secili i mbijetuar e ka rrëfimin e vet. Zëri që paralajmëronte tragjedinë për të burgosurit shqiptarë erdhi në mëngjesin e hershëm të datës 22 maj të vitit 1999. Pas natës më të gjatë të jetës sime, bashkë me qindra të burgosur të shtrirë nën qiellin e hapur, kur vetëm hëna dhe vdekja na bënë shoqëri, na shfaqet zëri i kriminelit tashmë të njohur për neve, i Svetllan Martinoviçit. Ai po jepte urdhrin për t'u rreshtuar afër murit të burgut, gjoja për të na transferuar për në Burgun e Nishit, duke na thënë se këtu më nuk kishte kushte qëndrimi pas bombardimeve të NATO-s.

Unë isha afër disa të burgosurve nga komuna e Deçanit dhe disa të tjerëve nga komuna e Gjakovës. Edhe pse ne nuk po besonim se bëhej fjalë për çfarëdo transferimi në Burgun e Nishit, njëri prej nesh tha: “Çka do që të ndodhë, të mos largohemi nga njëri-tjetri”. Ishte Gazmend Imeri, njëri nga pjesëtarët e hershëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i pari që kishte vërejtur përmes një vrime muri lëvizjet e ushtarëve dhe të policëve serbë, breshëritë e armëve, të cilëve pak kohë më pas lënë të vrarë e të masakruar qindra të burgosur shqiptarë. Mbi ne u zbrazen breshëri mitralozash, snajperësh, minahedhësish e granata dore. Aty pranë meje plumbat lanë të vdekur Gazmend Imerin dhe Ibër Metajn, ndërsa shumë të tjerë të qëlluar rëndë po përballeshin me frymën e fundit që po u ndërpritej nga mizoria më e pamëshirshme ndaj shqiptarëve të burgosur.

Oborri po mbulohej me gjakun e të vrarëve, disa metra më larg Dervish Sylaj nga Ratishi i Deçanit po përsëriste aktin e heroizmit, ndonëse i bërë shoshë nga breshëritë e armëve të vrastarëve serbë, ai po hapte gjoksin dhe po klithte me gjithë zërin e tij të mbytur nga plumbat: “Qëlloni kriminelë, qëlloni, kurrë më Kosova nën Serbi”.

Të nderuar deputetë,

Në Burgun e Dubravës deri më sot janë identifikuar 120 të vrarë dhe qindra të tjerë të plagosur. Vetëm nga komuna prej nga unë vij, komuna e Deçanit, kanë rënë në këtë masakër: Zekë Hasanmetaj, Adem Jasiqi, Gani Lekaj, Hajdar Pepaj, Metë Osmanaj dhe Naim Kurmehaj. Dhe, disa të tjerë kanë vdekur si pasojë e torturave gjatë qëndrimit në burgje, si: Hysni Dautaj, Afrim Hasaj dhe Zeqë Hasaj, i cili ishte arrestuar bashkë me djalin e tij, Armendin, më 18 maj në Bjeshkën e Belegut, në ditën kur ra dëshmor Shpend Hasaj. Dhe tash së fundmi si pasojë e plagëve dhe vuajtjeve nëpër burgjet serbe ka vdekur edhe Xhemsat Shehu.

Të nderuar deputetë,

Kështu 20 vjet pas, kalimthi u ktheva në mëngjesin e Ilahtarshëm të 22 majit të vitit 1999 të masakrës së Dubravës dhe në këtë rast kujtoj se përmasa e kësaj masakre, edhe sot e pandriçuar, nuk ka ndodhur rastësisht.

Po rikthehem në kronologjinë e kthimit të burgosurve shqiptarë nga burgjet e Serbisë në vendin famëkeq Dubravë për të dëshmuar skenarin e shtetit të Serbisë. Tashmë burgjet kudo ishin stërmbushur me të burgosur shqiptarë dhe rikthimi ynë këtu nuk ka se si të shpjegohet ndryshe, veçse realizim i skenarit makabër të pushtetit serb që u realizua egërsisht më 22 maj të vitit 1999. Më 29 dhe 30 prill 1998 bëhet ritransferimi nga Burgu i Dubravës në burgjet serbe i të gjithë të burgosurve politikë, me arsyetimin se kjo po bëhej për shkaqe sigurie. Transferimet kryesisht janë bërë në atë kohë në kazamatet e Nishit dhe të Mitrovicës së Stremit. Më 12 gusht të vitit 1998 nga Burgu i Pejës, së bashku me qindra të burgosur, na transferuan në burgjet e Serbisë. Stacionimi im, bashkë me disa të burgosur nga grupi i madh ishte Burgu i Nishit. Fillimi i bombardimeve të caqeve serbe fillon edhe ringjalljen e shpresave jo vetëm për të burgosurit, por edhe për lirinë e vendit. Bota demokratike për herë të parë po vihej në mbrojtje të një populli dhe të një lufte të drejtë dhe pikërisht në këtë kohë rifillojnë sërish transferimet e të burgosurve që tashmë ishin shtruar në pengje lufte.

Më 26 prill 1999, 45 të dënuar politikë nga Burgu i Mitrovicës së Sremit transferohen në Burgun e Nishit. Ato ditë në këtë burg unë dhe qindra të tjerë po përjetonim torturat më çnjerëzore që njih historia e njerëzimit. Kam pasur fatin të përjetoj torturat nëpër burgjet politike edhe në vitet '81, '83 dhe '92, por këto të fundit ishin të paimagjinueshme për mendjen e njeriut. Në mbrëmjen e 26 prillit në Burgun e Nishit dhuna nga kati i dytë, ku gjendeshim ne, po bartej në katin e parë te grupi i Ukshin Hotit, Nait Hasanit, Arif Vokshit dhe të burgosurve të tjerë të njohur politikë. Më lehtë ishin ndier kur dhuna ushtrohej direkt në katin tonë, se sa kur dëgjonin britmat e kriminelëve serbë që i torturonin mizorisht 45 të ardhurit nga Burgu i Mitrovicës së Sremit. Torturat e katit të parë nuk pushuan tri ditë rresht.

Më 29 prill, të gjithë të burgosurit politikë të kateve 1 dhe 2 na transferojnë me tre autobusë në drejtim të panjohur. Gjatë gjithë rrugës shoqëroheshim para e pas nga forca të mëdha serbe, ndërsa nga ajri aeroplanët e NATO-s vëzhgonin këtë rrugëtim tonin të panjohur. Të lidhur dy nga dy për karrige autobusi, ne bënim këtë rrugëtim, cakun dhe skenarin e të cilit nuk e dinim. Çfarë coincidence? Me një palë pranga dhe në një karrige autobusi isha i prangosur me ish-nxënësin tim, të riun Lavdërim Tetaj. Ne nuk po flisnim më për orët mësimore të dikurshme, por për fatin tonë dhe për fatin e vendit. Me të arritur në Orllat, pa pritur nga bombat e aeroplanëve të NATO-s qëllohet njëra nga autobлиндat që na shoqëronin në rrugëtimin e paditur. Avionët nga qielli, duke shkatërruar edhe urën, e ndajnë kolonën në dysh.

Një autobus me plot të burgosur, në mesin e të cilëve edhe Ukshin Hoti, vazhdon në drejtim të Dubravës, ndërsa dy të tjerë kthehen pas për t'u stacionuar një natë në Burgun e Lipjanit. Të nesërmen në mëngjes, të dy autobusët në rrugë alternative mbërrijnë në Dubravë. Ishte 30 prilli kur dy autobusët me plot të burgosur, tashmë ishin në vendin ku do të ndodhte krimi. Po këtë ditë në Dubravë sillen edhe të burgosurit nga burgjet e Prizrenit, Lipjanit dhe Gjilanit. Ndërsa më 18 maj 1999 sillen edhe 155 civilë nga Gjakova. Sipas informatave tona, tashmë në këtë burg ishin afro njëmijë të burgosur shqiptarë. Grumbullimi i gjithë këtyre të burgosurve në një vend paralajmëronte skenar të tmerrshëm. Tashmë Serbia e kishte arritur qëllimin e grumbullimit të pothuajse shumicës së të burgosurve në Dubravë, ku edhe ndodhi krimi dhe gjenocidi ndaj të burgosurve shqiptarë.

Shumë nga të burgosurit që tashmë ishin bashkuar në Dubravë i kisha njohur më herët, që nga viti 1981 e deri te vitet '90-ta. Një pjesë prej tyre kam pasur fatin t'i njoh para dhe pas Dubravës, në burgjet e Pejës, Nishit, Leskocit, Beogradit, Lipjanit dhe Mitrovicës së Sremit. Dhe me gjithë këtë masakrim, te të mbijetuarit morali nuk ishte thyer. Në rrethanat e krijuara, pa dashur të përmend emra, organizimi për ndihmë dhe shpëtimi i shokëve ishte i pashoq. Të burgosurit e mbijetuar bëheshin mjekë për të shpëtuar jetë.

Të nderuar deputetë,

Kujtoj se nuk është ndriçuar as për së afërmi përmasa e këtij gjenocidi. Kriminelët që vranë e masakruan të burgosur shqiptarë kanë emër dhe mbiemër. E ata janë drejtori i burgut Alekander Kovaçević, komandanti i burgut Miki Vidiq, mbikëqyrësi Branko Komatina, milici Grko Igor. Mandej gardianët Aca, Mitri, Mance, Pexha e të tjerë, si dhe të burgosurit ordinerë serbë Svetlan Martinoviqi nga Vraka e Shkodrës, vrasës i familjes Cacaj nga Deçani, Boban Bashqeviqi nga Nikshiqi, Ilija Bishkoviqi nga Çaçaku e të tjerë. Të gjithë këta kriminelë shëtitin të lirë në Beograd e në vende të tjera në Serbi, ndoshta edhe gjithandej Evropës.

Të nderuar deputetë,

Masakra në Burgun e Dubravës ishte kryer me urdhër të Qeverisë së Serbisë. Në vitin 2006, lënda e masakrës së Dubravës kinse për thjeshtësim të procesit, u hoq fare nga aktakuza e Tribunalit të Hagës kundër ish-zyrtarëve të lartë të Serbisë, Milan Milutinoviq, Nebojsa Pavkoviq dhe Streten Lukiq, të akuzuar për krime lufte në Kosovë. Çuditërisht, më 15 tetor 2010, edhe Prokuroria Serbe për Krime Lufte në Beograd pranoi se masakra mbi të burgosurit shqiptar në Burgun e Dubravës është kryer me urdhër të Qeverisë së Serbisë.

Bazuar në dokumentet zyrtare, Prokuroria Serbe thotë se masakra është bërë me urdhër të ministrit të atëhershëm serb të Drejtësisë, Dragolub Jankoviq dhe zëvendëskryeministrit të Republikës Federale të Jugosllavisë, Nikola Shainoviq. Është shumë e çuditshme sesi një fakt i tillë për një masakër kaq të tmerrshme siç ishte masakra në Burgun e Dubravës kaloi në heshtje, duke mos e zgjuar as interesimin e Prishtinës zyrtare e as të institucioneve ndërkombëtare. Vetë

rasti Dubrava mjafton që Serbia të përgjigjet për gjenocidin e kryer në Kosovë. Masakra në Burgun e Dubravës paraqet në radhë të parë krim kundër njerëzimit.

Të nderuar deputetë,

Krejt në fund, ndoshta tingëllon ironike, por më shumë është revoltë dhe zhgënjim ajo që tash po e them në fund të fjalës sime: Kriminelët serbë që ushtruan gjenocid mbi ne, ose duhet të nxirren para drejtësisë, ose bashkësia ndërkombëtare le t'i shpallë heronj, sepse gjithnjë sipas Serbisë ata kanë vrrarë terroristë shqiptarë.

Meqenëse Kosova ka themeluar Gjykatën Speciale vetëm për ushtarët e UÇK-së për krime të pretenduara, por jo për kriminelët serbë që bënë krim e gjenocid, atëherë nuk është çudi e as e papritur që ne të mbijetuarit e masakrës në Burgun e Dubravës të akuzohemi për krime, e jo ata që na vranë, kriminelët e pandëshkuar tash e njëzet vjet e që kanë emër e mbiemër.

Lavdi të rënëve në masakrën e Burgut të Dubravës! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Mirjeta Kalludra e ka fjalën në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

MIRJETA KALLUDRA: Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumë të respektuar të mbijetuar të masakrës së Dubravës që sot jeni me ne,

Gjatë luftës në Kosovë kanë ndodhur shumë akte barbare, vrasje të civilëve të pambrojtur, përdhunime, shkatërrime sistematike të pronës dhe masakra kolektive siç është ajo e Mejës, e Krushës, e Poklekut, e Kralanit, e Suharekës, e Qyshkut, e Reçakut, e Obrisë e shumë të tjera. Secila nga këto është pjesë e paharrueshme e vuajtjes së Kosovës dhe historisë së saj. Masakra e Dubravës, të cilën me dhimbje e kujtojmë sot në 20-vjetorin e saj ndaj të burgosurve, është simbol i zi i veprimeve çnjerëzore të Serbisë në Kosovë. Masakra e Dubravës është një vepër kriminale e organizuar dhe e orkestruar direkt nga shteti serb dhe nuk mund të cilësohet ndryshe. Aty në mënyrë të organizuar forcat serbe i kanë sjellë të burgosurit shqiptarë me qëllimin e vetëm, që të kryhet në formën më mizore krimi, ndërsa të mbijetuarit ta përjetojnë tmerrin e papërshkrueshëm.

Në përkujtimin e këtij përvjetori, ne si qytetarë të Republikës së Kosovës, edhe si përfaqësues institucionalë jemi të obliguar që të bëjmë çdo përpjekje që drejtësia të vihet në vend. Ne jemi të vetëdijshëm se askush nuk mund ta përshkruajë ngjarjen më saktë sesa ata që e përjetuan këtë tmerr. Rrëfimet e tyre janë rrëqethëse. Edhe na e kthejnë kujtesën e ditëve të tmerrshme të krimeve serbe në Kosovë. Thelbi i përkujtimit të sotëm duhet të jetë kërkesa për ta thënë të vërtetën për luftën tonë, për njerëzit tanë, për ata që ranë dhe për të gjithë ata që ende i kanë plagët e hapura.

Të nderuar të pranishëm,

Kolegë deputetë,

Masakra e Dubravës mbetet një akt i rëndë, tipik për një aparat shtetëror kriminal. Ne kemi të mbijetuar të asaj masakre edhe në mesin tonë, kolegë tanë deputetë. Po ashtu të tjerë ende konsiderohen të pagjetur dhe nuk dihet për fatin e tyre, siç është rasti i profesorit Ukshin Hoti. Ne jemi të lirë falë mundit të luftës sonë dhe ndihmës së aleatëve tanë, ndërsa të gjithë ata që ranë janë garanci e lirisë së Kosovës.

Dhe në fund, të nderuar deputetë dhe ju të pranishëm, në emër të LDK-së edhe një herë shpreh solidaritetin e thellë me të gjithë ata që kanë humbur më të dashurit në masakrën e Dubravës dhe kërkojmë që drejtësia të vihet në vend. Vetëm atëherë ne mund të kemi një shoqëri që mund të prosperojë, sepse pa drejtësi nuk ka të ardhme në këtë vend. Faleminderit!

KRYETARI: Bilall Sherifi dhe në fund e kemi kryetaren e Komisionit, zonjën Duda Balje dhe Miliam Zeka, s'ka të lajmëruar tjetër.

BILALL SHERIFI: I nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë,

Në veçanti kolegë të mbijetuar të masakrës së Dubravës,

Të nderuar mysafirë,

Sidomos të nderuar ju që ishit në Dubravë në kohën kur u krye ky akt gjenocidi mbi ju,

Të nderuar familjarë të viktimave,

Është vështirë të gjenden fjalë për të thënë më shumë sesa që u thanë nga tre të mbijetuarit, por megjithatë vendosa të dal dhe t'i them disa fjalë. Kjo seancë vjen vetëm disa ditë pas miratimit të rezolutës nga Kuvendi i Kosovës, rezolutë nëpërmjet së cilës Kuvendi konstaton se regjimi i Serbisë, shteti i Serbisë ka kryer gjenocid në Kosovë. Dhe, një nga provat e asaj rezolute është edhe masakra e Dubravës. Dhe, dëshmitarë të asaj masakre janë deputetë të sotëm dhe ish-deputetë, janë njerëz të cilët çojnë jetë të zakonshme dhe ne nuk i dimë, por rrethi i tyre, populli në përgjithësi i njeh, i ka në mesin e tyre.

Tash, ajo çka desha të them është që sidomos i lus kolegët nga politika, këtu nuk ka vend për merita. Jemi vonuar, ne jemi vonuar si politikanë. Por, nuk është vonë. Dola këtu për të theksuar, për të nënvizuar pikërisht këtë që po përsëritet në vazhdimësi se është vonë. Nuk është vonë. Të jemi vonuar ne dhe të jetë vonë janë dy gjëra krejt të ndryshme. Nuk pranoj unë dhe besoj që as ju nuk pranoni. Nuk pranon askush që të konstatojë që ndjekja e krimeve, se për ndjekjen e krimeve është bërë vonë. Asnjëherë. Asnjëherë nuk bëhet vonë. Bile, madje për të ndjekur dhe për të proceduar krimin e gjenocidin tani është koha, koha më e mirë sesa që mund të ketë qenë dje apo mund të jetë nesër.

Të nderuar kolegë,

Masakra e Dubravës është përmendur çdo vit, është përkujtuar çdo vit. Masakrat përkujtohen çdo vit. Por, nuk besoj që mund të themi diçka më shumë, por fakti që nuk kemi për të thënë diçka më shumë, nuk do të thotë që nuk duhet t'i përsëritim ato. Ne duhet t'i përsëritim vazhdimisht. Sepse, nëse ne nuk i përsëritim, nuk i përsërit askush për neve. Dhe, tash është koha që tash përpos që duhet t'i përsëritim në seanca të Kuvendit, përpos që duhet t'i përsëritim në debate televizive, në ndeja, gjithkund ku jemi, duhet t'i bëjmë dy veprime konkrete. Së pari duhet t'i përfshijmë në librat e historisë sonë. Ne nuk i kemi të përfshirë në libra të historisë, t'ua mësojmë gjeneratave që vijnë.

Mos harroni, ne po shkojmë gradualisht, po vijnë gjenerata, ato gjëra, nëse nuk ka tubime përkujtimore s'kanë ku t'i mësojnë. Duhet të gjitha këto t'i futim në libra të historisë, nën një. Dhe, nën dy, shpejt, sa më shpejt të kalojë ligji, Kodi Penal që mundëson ndjekjen penale në mungesë, në mënyrë që të gjithë ata që ju i përmendët këtu të mbijetuar dhe të gjithë ata që të tjerët i dinë të mund të ngrihen aktakuzat, të mund të bëhen formale aktakuza dhe të fillojë procesi kundër tyre. Vetëm kështu mund ta detyrojmë apo mund ta nxitim, se nuk po e përdor shprehjen detyrim, për të mos na e marrë si megalomani, por mund t'i nxitim, mund t'i inkurajojmë edhe botën demokratike që të thonë ngadalë se krimi i gjenocidit në Kosovë nuk mund të heshtet.

Menjëherë pas luftës na thanë që Serbia është shtet me traditë dhe ajo është në gjendje t'i dënojë krimet e veta. Prandaj, do ta lëmë Serbia vetë të merret me kriminelët e saj, me përjashtim të nivelit të lartë, ku ata do të gjykohen nga Gjykata e Hagës, do të akuzohen dhe do të gjykohen nga Gjykata e Hagës. Ndërsa ju nuk jeni të aftë të gjykoni krimet e juaja, prandaj do t'ua marrim ne. Pra, drejtësinë për krimet që i keni kryer ju, do ta ushtrojmë ne, ndërsa drejtësinë për krimet që i ka ushtruar Serbia do ta ushtrojë Serbia vetë. Kështu na thanë.

Për arsye të ndryshme, unë them dikush e besoi, dikush iu nënshtrua kësaj, dikush nuk e besoi në asnjë çast, dikush e besoi, ku ta di unë, nuk dua të hyjë në ato çështje, por koha dëshmoi që ajo ka qenë e gabuar, sepse në katër instanca u morën nëpër duar krimet e pretenduara të kryera nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, duke filluar nga gjykatat e UNMIK-ut, EULEX-it, Haga, Gjykata Speciale tanimë. Ndërsa për krimet e kryera nga Serbia, vazhdonin herë pas herë thoshin nga një fjalë që Serbia duhet seriozisht të trajtojë dhe të gjykojë krimet e kryera në Kosovë. Edhe kaq mjaftonte. Kurrfarë presioni tjetër. Sepse kënaqeshin me faktin që Serbia i dorëzonte ndonjë kriminel tek tuk në Hagë dhe vetëmjaftoheshin. Fatkeqësisht edhe ne jemi vetëmjaftuar për një kohë të gjatë me faktin që herë pas herë organizoheshin disa procese gjyqësore në shkallë të parë dhe shkalla e dytë i lironte. Pra, atë teatrin që neve nuk na e lanë në emër të asaj se mund të bëjmë teatër me gjykimin e krimeve të luftës, në Serbi e kishin para hunde, para syve dhe nuk i pengonte. Në emër të asaj se është shtet me traditë dhe paska kapacitete të gjykojë krimet e luftës. U pa që s'paska kapacitete.

Por, këtë tash ne duhet ta provojmë duke vepruar ne së pari. Dhe po e përsëris në emër të asaj që thash se asnjëherë nuk është mjaft të thuhet. Duhet t'i përsërisim gjërat. Nëse për botën do të jetë e papranueshme një tribunal për të gjykuar krimet e Serbisë në Kosovë, atëherë kur ne t'i gjykojmë, të gjitha gjykatat e tyre do të bëhen tribunale për krimet e kryera të Serbisë në Kosovë. Nëse shpallet një aktgjykim, akuzohen dhe shpallet një aktgjykim, po ndalem meqë jemi te seanca për krimin e gjenocidit në Dubravë, për të akuzuarit në rastin e Dubravës dhe ngrihet aktakuza, në shkallë të parë dënohen në mungesë, në shkallë të dytë apeli ua konfirmon, atëherë do të kesh një aktgjykim të shkallës së prerë me emra dhe me mbiemra dhe me përgjegjësinë e shtetit të Serbisë, që është e dëshmuar siç u tha edhe nga dëshmitarët këtu deputetë në seancë.

Ne do të mund ta vëmë në presion Serbinë dhe botën demokratike se ata të cilët janë gjykuar nuk mund të rrinë qetë në shtëpitë e tyre, sepse duhet të përgjigjen për këto krime. Kjo është mënyra e vetme e duhur që ta vëmë në lëvizje mekanizmin e kërkimi të drejtësisë. Me veprime konkrete. Gjithsesi janë të domosdoshme përkujtimet, gjithsesi që janë të domosdoshme fjalët në Parlament, gjithsesi që janë fjalët e nevojshme, përsëritja përmes fjalëve gjithkund.

Por, tani është koha, thash ne jemi vonuar, po nuk është vonë që të veprojmë, të nxjerrim aktakuza gjykatat, prokuroria të ngritë aktakuza, gjykata të shpallë aktgjykime dhe kur ato të kenë formën e prerë, të jeni të sigurt që nuk do të mund askush t'i mbyllë sytë para saj. Sepse kur dëgjon rrëfimin e juve këtu, po qe se e merrni e shkruani një skenar për një film dhe e dërgoni te një shtëpi filmike në Hollivud, besoni që do t'ju thonë paskeni imagjinatë shumë të zhvilluar, sepse mendja e shëndoshë nuk e kap këtë. Dhe kur ju t'ju thoni kjo nuk është pjellë e imagjinatës tonë, por është ngjarje e vërtetë të cilën e kemi jetuar, do t'ju thonë ju qenkeni të krisur, se si është e mundur kjo. Nuk mund të besoj mendja e shëndoshë, se një mendje kriminale siç ka qenë ajo e Serbisë ka mund të shkojë aq larg saqë njerëzit të cilët i ka pasur brenda mureve t'i vrasë sikur kafshë, jo sikur njerëz.

Pra, heshtja e deritashme nuk na bën nder. Por, mosveprimi tash e tutje do të na turpërojë edhe më shumë. Ne, i dëgjova edhe vërejtjet e Naitit. Vërtet dikush duhet të japë llogari, shpjegime pse të gjitha ato veprime që janë ndërmarrë, nuk kanë rezultuar me veprime konkrete. Nuk mund të flas tash në emër të të gjitha institucioneve.

Për fund, do të kisha pasur dëshirë që së paku në këtë çështje të mos bëjmë gabim. Kjo çështje, sidomos krimet e gjenocidit në Kosovë, kullojnë gjak, ende kullojnë gjak. Kushdo që dëshiron të përfitojë nga ai gjak që kullon, besoni nuk do t'ia sheh hairin.

Nuk vend për vrap për merita, por nuk ka vend as për heshtje dhe tërheqje për shkak se deri më tani nuk paskemi vepruar sa duhet.

Unë mbetem optimist dhe i gatshëm që në çdo kohë, në emër të Nismës të japim kontributin tonë që krimet e gjenocidit të kryera nga shteti i Serbisë në Kosovë, të marrin përgjigjen e merituar në çdo kohë dhe në çdo moment. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani, pas radhës së grupeve parlamentare, kryetarja e komisionit zonja Duda Balje. Pastaj nga deputetët është lajmëruar vetëm Milaim Zeka.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Poštovani poslanici,

Poštovane porodice onih koji nisu preživeli masakri u Dubravi,

Poštovani vi koji ste preživeli,

Drago mi je da ste danas ovde sa nama.

Ja sam prošle godine, prvi put imala priliku da posetim Dubravu, zajedno se Komisijom za ljudska prava, i sa mojim kolegama poslanicima. Ono što sam videla tamo moram da vam kažem da me vratilo u one momente kada sam bila u Bosni da podsećujem takve i slične mesta na kojima su se masakre dogodilo upravo od istih ljudi.

Masakra u Dubravi ima jedno posebno karakteristiku s obzirom od toga da su ljudi poubijani od onih koji su i zatvorili, i od onih koju su stvari trebali da ih čuvaju.

Ljude koje sam tamo videla bile se mlade devojke koje su plakale za roditeljima. Jedna stara žena koja sedala na stolici koju nikad neću da zaboravim, a njihov bol je bio veliki, a za mene sve to bilo vrlo teško zagledati.

U Komisiji za ljudska prava upravo posle toga smo se aktivirali, i komisija zajedno sa Agencijom za zaštitu monumente i direktorom koji danas ovdje, koga pozdravljam, doneli mo odluku za izgradnju onog spomenika kod onih jelki „Te pisha“, tamo gde su ustvari i taj masakr dogodio, i pokušali smo da ove godine formirali smo jedan organizacioni tim, koji je ove godine pokušao zajedno, pod okriljem Parlamenta, i zahvaljujem se predsedniku Kadri Veseljju, da napravimo ovu 20-godišnjicu mnogo većom, kako bi ljudima pokazali da se masakar tu desio, i da ne treba da se zaboravi.

Molim Boga da se više nikada ne ponovi. Više od 150 ubijenih, više od 300 ranjenih. Ljude za koje i dan danas ne znamo gde su. To nesme da se zaboravi. Pravda jeste možda spora, ali ja se nadam da će kad tad doći i vama čekam, i želim tu pravdu.

I vama se divim, vi ste oni koji nose ovu državu, vi ste oni koji nose sve ovo što se danas dešava. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti i fundit nga radhët e Nismës Socialdemokrate, Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Unë gjithmonë flas si deputet i pavarur kështu.

Sot jam zgjuar në mëngjes me intervistën e Liburn Aliut për përjetimet e tij në Burgun e Dubravës.

Të nderuar deputetë,

Arsyeja pse dola këtu, pra ajo që më shtyri të dal në këtë foltore, ish-shoku im Enver Dugolli, i cili është ulur atje, e që është nga djemtë më të mirë të Drenicës, i cili është organizatori kryesor i demonstratave të Drenicës në vitin 1981, i cili ka vuajtur tërë jetën e vet, nëpër burgjet e ish-Jugosllavisë dhe për fatin e mirë ka shpëtuar nga Masakra e Dubravës.

Zoti kryetar, edhe pse tema ka të bëjë me diçka tjetër, unë do të flas për krejt diçka tjetër. Do të flas diçka tjetër me qëllimin më të mirë.

Ju e dini që aty ku hyn CNN, aty gjithmonë pas CNN-it hynë Amerika, hyjnë bombardimet. Pse hyn televizioni CNN? Për ta parapërgatitur opinion amerikan se ne duhet të bëjmë ndërhyrje në këtë vend.

Shteti i Kosovës, që 20 vite, nuk ka bërë pothuajse asgjë, as për të burgosurit politikë, as masakrat, dhe këto do të mund t'i ndërtonim me qindra filma dokumentar për ta tronditur botën me të vërtetën se çfarë kanë bërë policia dhe ushtria serbe në Kosovë.

Në qoftë se televizioni i Suedisë ka ardhur dhe ka bërë film për masakrën në familjen Berisha në Suharekë. Në qoftë se Vjollca Berisha thotë që kur e kam marrë Gramosin 6-vjeçar, kanë ardhur dhe na kanë pushkatuar forcat serbe, i kanë ngarkuar në kamion për t'i çuar dhe për t'i varrosur, dhe Gramosi ka thënë: “nënë, shyqyr që nuk më kanë tërhequr prej duarve, se kam qenë i plagosur, por më kanë tërhequr nga këmbët”, kur e kanë hedhur në kamion. Pastaj, Vjollca së bashku me Gramosin kanë kërcyer në Saporc të Prizrenit nga kamioni për t'i shpëtuar asaj groposjeje.

Domethënë, televizionet e huaja kanë bërë me qindra filma, ne nuk kemi bërë asgjë.

Kryetar, kam një lutje për ty edhe për kryetarin e Qeverisë së Kosovës. Lexova që 220 000 euro, 31 zyrtarë i kanë shfrytëzuar në Venecia për një vizitë treditore, 220 000 euro.

Do të flas me emër e mbiemër se kush ka shkuar atje dhe sa para i ka harxhuar. Nuk po dua që ta prish këtë tubim.

Kryetar, kam lutje për ty edhe për kryetarin e Qeverisë: stop, stop, stop keqpërdorimit të parasë publike. Të hajnisë së parasë publike, dhe hajde të hyjmë edhe t'i tregojmë botës së çfarë ka bërë Serbia në Kosovë.

Hajde t'i bëjmë rreth 10 filma dokumentarë, vetëm për masakrën e Dubravës, edhe 400 masakra të tjera që kanë ndodhur në Kosovë.

Faleminderit prej jush! Respekt për jetë e mot edhe për të vdekurit, edhe prej juve të gjallët që keni shpëtuar nga masakra e Dubravës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Do ta marr fjalën si kryetar i Kuvendit.

Shumë të nderuar veprimtarë kombëtarë, të mbijetuar të masakrës së Dubravës,
Të nderuar familjarë, po ashtu të të masakruarve në Burgun e Dubravës,
Të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës,
Anëtarë të Qeverisë së Republikës së Kosovës,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Në çdo agjendë të çdo zyrtari publik të institucioneve të Republikës së Kosovës, agjende vjetore, është një radhë e gjatë e aktiviteteve që lidhen me ngjarjet që kanë ndodhur në periudha të ndryshme kohore.

Të gjitha këto ngjarje, të gjithë këta veprimtarë meritojnë respektin, vëmendjen e institucioneve të Republikës së Kosovës.

Por, pastaj janë dy problemet të cilat ndodhin; familjet dhe familjarët në disa raste me të drejtë mund të jenë edhe të hidhëruar pse nuk po arrijmë që të jemi në secilën ngjarje e cila ka ndodhur, për aq sa edhe në masakrat tona.

Minimumi, mendohet se janë 186 masakra, ndërkaq për aq sa flitet në bazë të një të dhënë të Kryqit të Kuq janë kryer 400 masakra vetëm në Republikën e Kosovës, e të mos flas pastaj për të rënë, komandantët tanë të rënë në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në qoftë se e shikojmë këtë pjesë, pastaj dy dekada prapa, është mendimi; cili është mesazhi që u japim gjeneratave të cilat vijnë, të cilat do ta trashëgojnë Republikën e Kosovës. Do të thotë këtyre të rinjve që i kemi tani, do tua dëshmojmë me veprimet tona të cilat janë tërësisht dinjitoze karshi respektit për veprimtarët, mirëpo a janë të mjaftueshme këto.

A është e nevojshme që shteti i Kosovës veç të vajtojë, kryetari i Kuvendit, kryeministri, presidenti, deputetët, ministrat, edhe të flasin dhe të sjellin çdoherë vetëm fakte të cilat janë të ndjeshme. Të gjithë i dimë. Jeni ju, janë gjëra të cilat i kemi parë, i dimë që dy dekada.

Apo t'ju japim një mesazh që ne nuk vajtojmë, ne nuk jemi institut i statistikës që t'i numërojmë plagët tona, por ne veprojmë. Veprojmë institucionalisht dhe do ta drejtojmë orientimin tonë, veprimet tona, po ashtu në atë drejtim.

Po ashtu, në të gjitha këto manifestime, të më besoni unë flas për veten time, po nuk besoj se ndonjë zyrtar publik në këto dy dekada që kanë shkuar, kur kanë dalë prej këtyre përkujtimeve që nuk i ndodhur një herë që t'ia thonë familjarët edhe një fjalë; të bëni diçka, mos i mbyllni sytë.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ne mund ta dëmtojmë njëri-tjetrin, se kjo është pjesa më e lehtë. Mund ta dëmtojmë, pastaj edhe secili çfarë ka bërë këto dy dekada, qoftë si pozitë, qoftë si opozitë, por deri më 2015, vetëm njëherë në 2007 për familjarët e të pagjeturve ka qenë një iniciativë në dokumente të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Pra, deri më 2015 ato fotografi kanë ndenjur vetëm jashtë në tela. Nuk ka mundur as të flitet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Do të thotë, sot po mund të flasim. Po i identifikojmë. Është në nderin e institucioneve të Republikës së Kosovës, që ta drejtojnë andej kah duhet gishtin, a ajo është Serbia.

Pra, te kriminelët të cilët i kanë kryer këto veprime edhe të marrim masat, veprimet institucionale të cilat nuk na bëjnë neve një shoqëri vajtuese. Nuk na bëjnë neve një shoqëri vetëm përkujtuese, por na bëjnë neve një shtet veprues, e i cili kërkon drejtësi edhe e vë drejtësinë në vend deri në fund. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Myfera Shinik.)

KRYESUESJA: Faleminderit, kryetar!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Të nderuar të mbijetuar të masakrës së Dubravës,
Familje të heronjve dhe të dëshmorëve dhe martirëve,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kuvendi i Republikës së Kosovës do të jetë gjithmonë shtëpi e hapur për t'i përshkruar këto përjetime dhe këto fakte të cilat kanë ndodhur gjatë luftës në Kosovë, luftë kjo që e përjetoj populli ynë.

Por, në ët njëjtën kohë Kuvendi duhet të marrë vendime të cilat, pikërisht e adresojnë këtë çështjen e gjenocidit serb në Kosovë.

Me kaq e mbyllim edhe këtë seancë. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*